

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Seanca Plenare

Seanca nr.2003/35

Prishtinë, më 11 dhjetor 2003, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

PROCESVERBAL

Seancën e kryesoi Nexhat **DACI**, kryetar i Kuvendit, kurse bashkëkryesues ishte Bajram Kosumi, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë ishin të pranishëm 91 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Në seancën e mëparshme ishte miratuar rendi i ditës i kësaj seance, si vijon:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme;
2. Shqyrtimi i parë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës-nr.2003/33;
3. Shqyrtimi i vendimit të panelit të posaçëm lidhur me mocionin e koalicionit "Kthimi" në Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave;
4. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës dhe të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për shpalljen e pazbatueshme të disa akteve kushtetuese dhe ligjore dhe
5. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 18 dhjetorit 2003.

Kryetari kërkoi nga deputetët e Kuvendit të procedohet sipas rendit të ditës të miratuar në seancën e mëparshme.

Dragisha Krstoviq, në emër të Grupit parlamentar «Kthimi», propozoi që pika e katërt të hiqet nga rendi i ditës.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar «Kthimi» dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----15;
Kundër shumica;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin Grupit Parlamentar «Kthimi».

Alush Gashi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, propozoi që pika e tretë e rendit të ditës për seancën e ardhshme plenare të 18 dhjetorit 2003-Propozimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit rregullativ për telekomunikacion, si çështje urgjente, të vihet në rend dite të kësaj seance.

Kryetari tha se Kryesia e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe nuk e ka kundërshtuar asnjë kandidatë të propozuar, por nuk ka pasur informacion të mjaftueshëm për ta, prandaj këtë kërkesë e ka radhitur për seancën e ardhshme të 18 dhjetorit 2003.

Kryetari e ftoi ministrin e Transportit dhe të Postëtelekomit ta arsyetojë propozimin që kjo çështje të radhitet si çështje e ngutshme.

Ministri Zef Morina theksoi se themelimi i Bordit rregullator për telekomunikacion është i një rëndësie të veçantë, ngase ekziston nevoja për shpalljen sa më të shpejt të tenderit për një operator të telefonisë mobile në Kosovë. Me këtë do të rritet cilësia e shërbimeve të telefonisë mobile, do të mbulohet i tërë territori i Kosovës dhe do të ulen çmimet e shërbimeve të kësaj telefonie.

Gojko Saviq theksoi se Kryesia e ka shtyer propozimin e Qeverisë për seancën tjetër, ngase për asnjë kandidatë të propozuar për këtë Bord, nuk është dhënë biografia e tyre. Në këtë Bord janë propozuar pesë anëtarë, të gjithë shqiptarë, kurse në të duhet të ketë edhe ndonjë nga komunitetet e tjera. Prandaj, nuk janë krijuar kushtet që kjo çështje të radhitet si çështje e ngutshme.

Arsim Bajrami theksoi se ky propozim nuk mund të kualifikohet si çështje e ngutshme që të vihet në rend dite të kësaj seance. Deputetëve nuk u është shpërndarë propozimi i Qeverisë me emrat e kandidatëve për këtë Bord. Prandaj, Kuvendi nuk mund të marrë vendim pa pasur informacionin e mjaftueshëm për kandidatët e propozuar. Në seancën e ardhshme do të kemi më shumë informacione dhe do të mund të procedohet në mënyrë të rrregullt kjo çështje.

Bujar Dugolli theksoi se Grupi Parlamentar i AAK-së nuk është i gatshëm t'i mbështetë kandidatët e propozuar, sepse nuk e kemi biografinë e tyre. Kërkojmë për seancën e ardhshme të përgatiten të gjitha të dhënat dhe të kemi një pasqyrë të qartë kush është ai bord, kush e përbën atë, atëherë do të jemi të gatshëm që t'a mbështesim dhe të mos vonohet kjo procedurë.

Dragisha Krstoviq theksoi se Grupi Parlamentar i koalicionit "Kthimi" nuk e mbështet propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së që propozimi i Qeverisë për emërimin e Bordit rregullator për telekomunikacion të vihet në rend dite të kësaj seance. Nuk ka transparencë në propozimin e kandidatëve, ngase mungojnë biografitë e tyre.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e Grupit Parlamentar të LDK-së dhe rezultati ishte, si vijon:

Për-----shumica;

Kundër-----35;

Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi propozimin e grupit Parlamentar të LDK-së që të vihet në rend dite të kësaj seance propozimi i Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit rregullativ për telekomunikacionin.

1. Miratimi i procesverbali të seancës së mëparshme.

Procesverbali i seancës së mëparshme u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi parë i P/ligjit për Odën Ekonomike të Kosovës –nr.2003/33.

Kryetari e ftoi ministrin e Financave dhe të Ekonomisë ta arsyetonte para deputetëve këtë p/ligj.

Ministri Ali Sadriu theksoi se P/ligji në fjalë rregullon organizimin dhe funksionimin ligjor të bashkimit të subjekteve ekonomike në asociacionin e Odës Ekonomike dhe paraqet një hap të rëndësishëm në ndërtimin e sistemit ekonomik të Kosovës.

Oda Ekonomike e Kosovës ka funksionuar dhe funksionon sipas një ligji të zbatueshëm, i cili ishte nxjerrë në rrethana dhe kushte të një sistemi ekonomik krejt tjetër nga ai që synojmë të ndërtojmë. Prandaj, është e nevojshme që të kemi një ligj të ri i cili duhet të jetë në përputhje të plotë me sistemin e ri ekonomik e posaçërisht me kriteret dhe rregullat e funksionit të ekonomisë së tregut.

Çështja e cila ka ngelur e hapur dhe që pret të diskutohet është përcaktimi ynë i përbashkët se a duhet të krijohet hapësirë për subjektet ekonomike që në mënyrë vullnetare të bashkohen në Odën Ekonomike apo që ky bashkim të jetë i obliguar, që është paraparë në nenin 2 të këtij Projektligji.

Prandaj, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 13 nëntor 2003 ka miratua P/ligjin për Odën Ekonomike të Kosovës me dy variante dhe si të tillë e ka përcjellë në Kuvend.

Projektligji ka 7 pjesë dhe 36 nene.

Pjesa e parë përfshinë dispozitat e përgjithshme, me të cilat rregullohet themelimi i subjektit, selia, anëtarësia dhe detyrat e Odës.

Pjesa e dytë përcakton organet dhe strukturën organizative të Odës. Në këtë pjesë rregullohet themelimi i organeve të Odës, zgjedhja si dhe veprimtaria dhe roli i këtyre organeve.

Pjesa e tretë rregullon statusin e Odës Ekonomike të Kosovës, përkatësisht atë se çka rregullon dhe përcakton ai status.

Pjesa e katërtë rregullon dhe përcakton punën e Gjykatës së Nderit dhe arbitrazhit të përhershëm që funksionon në kuadër të Odës Ekonomike

Pjesa e pestë rregullon dhe përcakton mënyrën e arkëtimit të mjeteve për punën dhe ekzistencën e Odës Ekonomike.

Pjesa e gjashtë rregullon shërbimin profesional të Odës dhe punët e sekretarit të Odës Ekonomike, ndërkaq pjesa e shtatë parasheh dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Oda Ekonomike ka disa karakteristika të përbashkëta me grupet tjera, siç janë shoqatat e tregtisë dhe sindikatat e punëtorëve. Këto karakteristika të përbashkëta janë statusi joprofitabil, pjesëmarrja e llojllojshme, anëtarësimi dhe vetëqeverisja e tyre.

Në fund ministri Ali Sadriu i ftoi deputetët e Kuvendit ta miratonin këtë p/ligj.

Kryetari e-hapi diskutimin për shqyrtimin në parim të këtij p/ligji.

Arsim Bajrami theksoi se Grupi Parlamentar i PDK-së i jep mbështetje parimore miratimit të këtij P/ligji, i cili do të krijojë një bazë legale për funksionimin e Odës Ekonomike dhe do ta zëvendësojë ligjin e zbatueshëm. Duke pasur parasysh ekonominë e tregut dhe pluralizmin ekonomik, është mëse e domosdoshme që edhe Oda Ekonomike t'i përshtatet trendeve të ekonomisë së tregut dhe në një mënyrë të mbijetojë në hapësirën e tregut vetëm me vlera që iu ofron subjekteve ekonomike.

Kosova është në ndërtim të një ekonomie të tregut dhe ende nuk mund të themi se ka edhe sistem ekonomik të qëndrueshëm e lëre më e konomi të tregut. Ne duhet t'i shohim edhe m'odelet e shteteve në transicion, pra si i kanë zgjidhur ato statusin e odave ekonomike në periudhën e transicionit.

Gjatë shqyrtimit, me amendamente mund të përmirësohet cilësia e këtij P/ligji.

Alush Gashi theksoi se Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar këtë P/ligj dhe e ka mbështetur në parim. Gjatë shqyrtimit të tij në Komisionin funksional, ekspertët e Grupit Parlamentar të LDK-së do të japin kontributin e tyre që ky p/ligj të jetë i mirë, i qëndrueshëm dhe kompatibil me kohën sa i përket çështjes së odave ekonomike të Kosovës.

Naim Maloku theksoi se Grupi Parlamentar i AAK-së e mbështet në parim Projektligjin e propozuar për Odën Ekonomike të Kosovës. Variantet që u cekën këtu duhet të jenë temë shqyrtimi në procedurën në vazhdim. Ne do të japim kontributin tonë gjatë amendamentimit të tij.

Gani Sadik, në emër të Grupit Parlamentar të komuniteteve e tjera, theksoi se e përkrahim këtë Projektligj dhe do të votojmë për miratimin e tij në parim.

Dragisha Krstoviq, në emër të koalicionit "Kthimi" theksoi se edhe me këtë rast do të refuzojmë të përkrahim këtë ligj për disa arsye. Në preambulën e projektligjit, në paragrafin 2 thuhet: "me qëllim të koordinimit dhe realizimit të synimeve dhe interesave të përbashkëta për përparimin e bashkëpunimit ndërmjet anëtarëve dhe zhvillimin më të shpejtë e harmonik të vendit". Propozuesi i ligjit ka mundur që në vend të fjalës "vendit" të përdorë fjalën "Kosovës" dhe të mos jetë fare kontestuese.

Koalicioni "Kthimi" është i shtërnguar që vazhdimisht të ndërtojë mekanizma mbrojtës ndaj termave që prejjudikojnë statusin e ardhshëm të Kosovës.

Behxhet Brajshori theksoi se e përkrah në parim këtë P/ligj dhe e konsideron si një nga ligjet më të rëndësishme, sepse nëse arrihet harmonizimi i interesave të asociacioneve ekonomike dhe të komunitetit të bizneseve, ekonomia e vendit do të zhvillohet më shpejt.

Tomë Hajdaraj theksoi se e mbështet në parim këtë p/ligj, por ka vërjetje në lëminë e agrarit, por edhe lëmime tjera të biznesit. Në nenin 8 rregullohet lëshimi i dokumentacionit profesional për origjinën e mallit. Të njëjtën materie e rregullon Ligji për Tregti me Jashtë. Në nenin 18 thuhet se Oda Ekonomike e Kosovës njerrë akte nënligjore, kurse dihet se aktet nënligjore i nxerrin ministrinë ose Qeveria

Në nenin 24 ku rregullohet çështja e shoqatave të degëve, çështjen e kooperativave bujqësore saktësisht e ka rregulluar Ligji për kooperativat bujqësore. Me këtë p/ligj nuk duhet të dëmtohen strukturat organizative të të bizneseve që janë rregulluar me ligje tjera.

Ramadan Kelmendi theksoi se ky p/ligj nuk përcakton kushtet, mënyrën dhe kriteret e anëtarësimit në Odën Ekonomike duke mos përcaktuar edhe formën territoriale të anëtarësimit në

të, me çka lë mundësi që edhe jashtë Kosovës të anëtarësohen. Po ashtu, ky p/ligj nuk duhet të përfaqësojë vetëm interesat e biznesit, por duhet të përfaqësojë edhe interesat e subjekteve tjera ekonomike dhe joekonomike të anëtarësuarve në Kosovë. Këtij P/ligji i mungon edhe mënyra e anëtarësimit të subjekteve ekonomike dhe joekonomike si dhe përcaktimi i të drejtave, obligimeve dhe përgjegjësi të anëtarit të anëtarësuar. Po ashtu P/ligji lë të padefinuar rolin e arbitrazhit, Gjykatës së Nderit

Xhevdet Neziraj theksoi se ekonomia e Kosovës është e padefinuar prej pronësisë e deri te problemet institucionale. Ndërmarrjet dhe bizneset në Kosovë punojnë vetëm për ta siguruar ekzistencën. Prandaj, ka ardhur koha që subjektet që bashkojnë ndërmarrjet e në këtë radhë edhe Oda Ekonomike e Kosovës t'i bashkojë këto ndërmarrje.

Fetije Këpuska tha se këtij p/ligji, në të gjithë kapitujt, i mungon pajtueshmëria, mundësia dhe pozita e komunikimit të komunitetit të biznesit. Duhet të definohen përgjegjësitë dhe kompetencat e vetë Odës Ekonomike.

Blerim Baruti theksoi se me këtë P/ligj bëhet rikonstruktimi i Odës Ekonomike të Kosovës dhe definimi i statusit të saj është në interes të zhvillimit ekonomik të Kosovës.

Nerxhivane Dauti theksoi se rregullimi juridik i Odës Ekonomike të Kosovës, me ligj të veçantë, është i domosdoshëm duke marrë parasysh faktin se odat ekonomike paraqesin organizata profesionale dhe subjekt juridik të pavarur në Kosovë.

Në secilën odë ekonomike ekzistojnë gjykatat e nderit. Edhe në këtë P/ligj përmenden gjykatat e nderit, por në mënyrë fragmentare përcaktohet roli dhe rëndësia e tyre në praktikën afariste.

Gjykata e përhershme e zgjedhur apo arbitrazhi rregullohet me nenin 28 të P/ligjit duke përcaktuar shprehimisht se arbitrazhi i përhershëm është kompetent për zgjedhjen e kontesteve të biznesit në mes të anëtarëve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe personave tjerë juridik ose fizik.

P/ligji nuk përmbanë dispozita juridike lidhur me arbitrazhin për tregtinë e jashtme.

Në parim e përkrah këtë P/ligj, por duke pasur parasysh ndryshimet dhe plotësimet që duhen bërë në riformulimin e neneve 2, 6, 8, 27 dhe 28.

Në fund kryetari e hodhi në votë këtë p/ligj dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----

Kundër-----

Abstenime-----

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, e miratoi në parim P/ligjin për Odën Ekonomike të Kosovës dhe i ngarkoi komisionet kryesore dhe Komisionin Funkcional që ta shqyrtojnë këtë p/ligj brenda tri javësh dhe t'ia paraqesin Kuvendit raportet me rekomandime për miratim.

3. Shqyrtimi i vendimit të panelit të posaçëm lidhur me mocionin e koalicionit "Kthimi" në Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave.

Kryetari i informoi deputetët lidhur me kundërshtimin e këtij Ligji nga koalicioni "Kthimi" si dhe me procedurat për formimin e panelit të veçantë për shqyrtimin e tij.

Ai tha se Kryesia e ka shqyrtuar vendimin e panelit dhe njëzërit ka konstatuar se ndryshimet e propozuara nuk e ndërrojnë përmbajtjen e Ligjit dhe rekomandimi i panelit është i pranueshëm.

Bujar Dugolli i bëri një vështrim kritik rekomandimit të panelit lidhur me Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave dhe propozoi që Kuvendi ta miratojë vetëm nenin 8 pika 2, kurse të mos e miratojë nenin 18.

Alush Gashi tha se Grupi Parlamentar i LDK-së nuk e mbështetë rekomandimin e panelit.

Gani Koci tha se Grupi Parlamentar i PDK-së nuk e mbështetë rekomandimin e panelit, ngase arsyetimi është krejtësisht i pabazë dhe paneli nuk ka vepruar mbi bazën e propozimit të Koalicionit "Kthimi" për faktin se Koalicioni "Kthimi" nuk i ka kundërshtuar dispozita të veçanta të këtij ligji, por ka kundërshtuar në tërësi ligjin, prandaj edhe paneli është dashur të merret me ligjin si tërësi e jo me dispozita ose nene të veçanta, të cilat nuk kanë qenë objekt i kundërshtimit të Koalicionit "Kthimi".

Hydajet Hyseni theksoi se Kryesia e ka shqyrtuar kundërshtimin e Grupit Parlamentar "Kthimi" në këtë ligj dhe ka konstatuar se ligji nuk cenon liritë dhe të drejtat e komuniteteve, por pasi që nuk ka pasur koncenzus, ka vendosur të formohet paneli i veçantë për shqyrtimin e tij dhe Kuvendi të marrë vendim lidhur me të.

Gojko Saviq theksoi se Kryesia e Kuvendit e ka shqyrtuar rekomandimin e panelit lidhur me këtë ligj dhe të gjithë anëtarët e saj janë pajtuar me rekomandimet e tij.

Kryetari e hodhi në votë rekomandimin e panelit dhe rezultati ishte, si vijon:

Për-----24;
Kundër shumica;
Abstenime----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi rekomandimin e panelit lidhur me Ligjin për regjistrimin e popullsisë, të ekonomive familjare dhe të banesave dhe mbetet në fuqi ligji i miratuar në Kuvend më 11 korrik 2003.

4. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës dhe të Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese për shpalljen e pazbatueshme të disa akteve kushtetuese dhe ligjore.

Kryetari e ftoi kryetarin e Komisionit për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese t'i arsyetonte propozimin e Qeverisë dhe rekomandimin e Komisionit.

Arsim Bajrami theksoi se PSSP-ja ka nxjerrë Rregulloren 24/99, me të cilën ka përcaktuar kategoritë e ligjeve të aplikueshme dhe me këtë rast janë përcaktuar disa nga kategoritë, njëra prej tyre ka qenë mundësia e aplikimit edhe të ligjeve pas 22 marsit të vitit 1989. Unë mendoj se pas 22 marsit të vitit 1989 të gjitha ligjet që janë nxjerrë nga Republika e Serbisë dhe Federata Jugosllave janë të paaplikueshme për shkak se bëhet fjalë për ligjet që nuk kanë legjitimitetin e popullit të Kosovës dhe të organeve që e kanë përfaqësuar popullin e Kosovës dhe se këto kanë qenë ligje që i janë imponuar popullit të Kosovës.

Amendamentet kushtetuese të 23 marsit të vitit 1989 janë miratuar në mënyrë kundërkushtetuese, me të cilat është rrënuar subjektiviteti juridik dhe politik i Kosovës. Kushtetuta e Serbisë e vitit 1990 krijoi bazën legale për okupimin e Kosovës. E ashtuquajtura "Kushtetutë e Zhablakut" e vitit 1992, është një akt kushtetues i imponuar popullit të Kosovës. Dhe, së fundi Karta Kushtetuese e Unionit SMZ. Të gjitha këto akte kushtetuese janë akte që kanë krijuar bazën

konstitucionale për kryerjen e një agresioni kushtetues që është bërë në Kosovë dhe që në fakt, asnjëherë nuk i ka pranuar populli i Kosovës, por përkundrazi – ato janë imponuar dhunshëm me anë të një aparati shtetëror.

Këto akte kushtetuese kanë gjeneruar një varg ligjesh të tjera të nxjerra mbi bazën e këtyre akteve, me të cilat, në fakt, këtu jo vetëm që u krijua një praktikë diskriminuese por – lirisht mund të them – u vendos edhe një bazë e apartheidit në Kosovës, duke pasur parasysh faktin se shqiptarët për vite të tëra u trajtuan në një mënyrë si qytetarë të rendit të dytë.

Me këtë rast, Komisioni propozon që të gjitha aktet kushtetuese dhe ligjore, duke lënë anash atë se janë diskriminuese, apo jo të shpallen të pazbatueshme dhe të anulohen, apo të shpallen irelevante të gjitha efektet dhe pasojat juridike që kanë prodhuar këto ligje. Për shkak se pasojat juridike të këtyre ligjeve kanë qenë jashtëzakonisht të mëdha, jo vetëm në sferën e ekonomisë e privatizimit, por në të gjitha sferat e jetës.

Qeveria e Kosovës ka bërë një listë initiale se cilat ligje ia propozon Kuvendit të shpallen të pazbatueshme. Mirëpo, Komisioni propozon të mos identifikohen ligjet një nga një, por të gjitha ligjet jugosllave dhe ligjet serbe, pas 22 marsit 1989, të shpallen të pazbatueshme në territorin e Kosovës.

Kryetari e hapi diskutimin lidhur me propozimin e Qeverisë dhe rekomandimin e Komisionit Legjislativ.

Alush Gashi theksoi se Grupi Parlamentar i LDK-së e mbështet fuqimisht propozimin e Komisionit lidhur me këtë çështje dhe kërkojn nga Qeveria të zbatohet me përpikëri vendimin e Kuvendi.

Hajredin Kuçi, në emër të PDK-së, ua bëri një vështrim kritik të gjitha akteve juridike që kishte nxjerrë Serbia pas 22 marsit të vitit 1989 dhe i propozoi Kuvendit t'i ndërmarr këto masa: a) Të shpallen të pazbatueshme të gjitha ligjet, aktet nënligjore dhe dispozitat të tjera që janë nxjerrë nga organet serbe për Kosovën pas 22 marsit të vitit 1989; b) Të anulohen të gjitha pasojat juridike të krijuara me këto ligje dhe të merren masa për rikthimin në gjendjen e mëparshme; c) Të punojmë me intensitet të shtuar që të ndryshojmë edhe ligjet me prejardhje nga sistemi juridik komunist, duke ia përshtatur sistemit të ri konform standardeve ndërkombëtare; e) Të kërkojmë nga të gjitha institucionet vendore dhe ndërkombëtare që të respektojnë vendimin e Kuvendit të Kosovës; f) T'i bëjmë thirrje edhe vetë Serbisë që të bëjë ndryshimet mbi tendencat e tyre për sovranitetin mbi Kosovën; g) Kuvendi i Kosovës edhe një herë të shprehë gatishmërinë për të nxjerrë ligje në përputhje me aktet ndërkombëtare që afirmojnë barazinë qytetare; dhe h) Të njoftohen të gjitha qendrat vendimmarrëse ndërkombëtare për këtë vendim.

Dragisha Krstoviq, në emër të Grupit Parlamentar «Kthimi» theksoi se vendimi i Kuvendit që mund të merret lidhur me këtë çështje, juridikisht nuk mund të qëndrojë, ngase bie ndesh me Rregullorën e PSSP-së lidhur me këtë materie

Dhe me Rezolutën e OKB-së nr. 1244.

PSS-ja, do t'i përdorë mjetet juridike konform përgjegjësive që ka lidhur me vendimin eventual të Kuvendit.

Bajram Kosumi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, theksoi se i përkrah propozimin e Qeverisë dhe rekomandimin e Komisionit legjislativ për shfuqizimin e të gjitha akteve juridike të Serbisë në territorin e Kosovës. Shfuqizimi i tyre do të krijonte efekte pozitive juridike për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Faik Marolli theksoi se Grupi parlamentar i komuniteteve të tjera e mbështet rekomandimin e Komisionit Legjislativ.

Oliver Ivanović theksoi se konstatimi i parafolësve, se aktet juridike që i kanë nxjerrë Serbia dhe Jugosllavia pas 22 marsit të vitit 1989, nuk kanë legjitimitet dhe janë diskriminuese, nuk është i saktë.

Ai pyeti nëse Kuvendi i shpallë të pazbatueshëm ato akte juridike, cilat ligje atëher do të zbatohen në Kosovë?

Ministri Ali Jakupi, në emër të Qeverisë së Kosovës, e arsyetoi propozimin për shpalljen e pazbatueshme, për territorin e Kosovës, të gjitha akteve kushtetuese, ligjore dhe nënligjore që i kanë nxjerrë Serbia dhe Jugosllavia pas 22 marsit të vitit 1989, si dhe të gjitha efektet e dëmshme që aktet e tilla i kanë shkaktuar në vazhdimësi për Kosovën dhe për qytetarët e saj.

Gojko Saviq e kundërshtoi konstatimin e parafolësve se aktet kushtetuese dhe ligjore që i kanë nxjerrë Serbia dhe Jugosllavia pas 22 marsit të vitit 1989, janë diskriminuese. Ai shtoi se edhe disa ligje që i kanë nxjerrë Kuvendi i Kosovës janë diskriminuese për bashkësinë serbe.

Kryetari i hodhi në votë propozimin e Qeverisë dhe rekomandimin e Komisionit Legjislativ dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----17;
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash, i miratoi propozimin e Qeverisë së Kosovës dhe rekomandimin e Komisionit Legjislativ për shpalljen e pazbatueshëm të të gjitha akteve kushtetuese, ligjore dhe nënligjore, për territorin e Kosovës, që i kanë nxjerrë Serbia dhe Jugosllavia pas 22 marsit të vitit 1989.

5. Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarve të Bordit Rregullator për Telekomunikacion.

Qeveria i kishte propozuar Kuvendit për anëtarë të Bordit Rregullator për Telekomunikacion këta persona:

1. Lulzim Kurtaj, inxh. i dip. elek;
2. Anton Berisha, inxh. i dip. elek;
3. Lutfi Zharku, ecc i dip;
4. Ilir Dugolli, jur. i dip. Dhe
5. Fazli Shala, inxh. i dip. elek.

Kryetari e hodhi në votë propozimin e Qeverisë dhe rezultati ishte si vijon:

Për-----shumica;
Kundër-----22;
Abstenime-----10.

Kryetari konstatoi se Kuvendi i Kosovës, me shumicë votash e miratoi propozimin e Qeverisë për emërimin e Bordit Rregullator për Telekomunikacion.

6. Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 18 dhjetorit 2003.

Kryesia i kishe propozuar Kuvendit rendin e ditës për seancën plenare të 18 dhjetorit, si vijon:

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për buxhetin vjetor të Kosovës për vitin 2004 dhe
2. Shqyrtimi i legjislacionit për bashkëpunim me Tribunalin penal të Hagës.

Hajredin Kuqi, në emër të Komisionit për Arsim, Shkencë dhe Teknologji, propozoi që P/ligji për buxhetin e Kosovës për vitin 2004 të shtyhet për seancën tjetër me arsyetim se P/buxheti duhet të rishqyrtohet në fushën e arsimit.

Mahir Jagxhillar propozoi që Kuvendi i Kosovës duhet ta dënojë sulmin që kishte ndodhur, në veri të Mitovicës kundër, kryeminitrit të Kosovës.

Agim Krasniqi, në emër të Komisionit për Gatishmëri Emergjente, propozoi të vihet në rend dite të seancës plenare të 18 dhjetorit 2004 rekomandimi i këtij komisioni lidhur me Shërbimin Sizmologjik të Kosovës.

Alush Gashi, në emër të Grupi Parlamentar të LDK-së, propozoi të ftohet përgjegjësi për rend dhe siguri dhe t'i raportojë Kuvendit në seancë ardhshme, lidhur me sulmin kundër kryeministrit të Kosovës.

Ministri Ali Sadriu kërkoi të mos shtyhet për ndonjë seancë tjetër shqyrtimi i P/buxhetit të Kosovës për vitin 2004.

Kryetari theksoi se Kryesia e Kuvendit do t'i shqyrtojë propozimet e dhëna lidhur me rendin e ditës.

Kuvendi, me propozimin e Kryesisë, e miratoi rendin e ditës të seancës plenare të 18 dhjetorit 2003, në formën e propozuar.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën plenare në orën 13:30 minuta.

Sekretaria e Kuvendit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës

Akademik Nexhat DACI